



UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations  
Unies au Kosovo



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës  
Nr. 02-59/20-07  
Prishtinë, më 27 gusht 2007  
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë janë të pranishëm 75 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 27 e 31 dhe 30 korrikut 2007;
2. Koha për pyetje parlamentare;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët, nr.2003/11;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin e institucioneve të Kadastrit;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
6. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006;
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për bartjen e mjeteve buxhetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007;
8. Shqyrtimi i Projektrezolutës për KXM "Trepça", të propozuar nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Miniera, Transport dhe Telekomunikacion;
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me propozimin e Prokurorisë Publike të Kosovës për emërimin e një anëtari në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Në fillim të seancës, **kryetari** i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Ndërkohë, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Miniera ka propozuar që Kuvendi ta nxjerrë një Deklaratë lidhur me KXM "Trepça".

Deputetja **Besa Gaxheri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, propozoi që Kuvendi të marrë vendim që fotografia e ish- Kryetarit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, të vendoset në të gjitha zyret e institucioneve publike të Kosovës.

Deputeti **Gjegj Dedaj** kërkoi që deputetët e Kuvendit të informohen lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë.

**Kryetari** tha se propozimet duhen të parashtrohen me shkrim, në përputhje me rregullat procedurale të punës së Kuvendit.

## 1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 27 dhe 30 korrikut 2007

Procesverbalet e seancave plenare të 27 dhe 30 korrikut 2007 u miratuan pa vërejtje.

## 2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtrroi pyetje ministrit të Energjetikës dhe të Minierave lidhur me furnizimin dhe lirin nga pagesa e rrymës elektrike për banorët fshatrave të komunës së Kastriotit, afër termoelektranave.

Ministri **Ethem Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputeti **Emrush Xhemajli** i parashtrroi pyetje ministrit të Drejtësisë lidhur me mosekzekutimin e lëndëve të përfunduara nëpër gjykatat e Kosovës.

Ministri **Jonuz Salihaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Xhelal Canziba** i parashtrroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Posttelekomunikacionit lidhur me asfaltimin e rrugës që lidh Therandën me Rahovecin.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Canziba.

Deputeti **Nait Hasani** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, lidhur me furnizimin e bizneseve me derivate të mazutit.

Kryeministri **Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.